

VENDIM
Nr. 618, datë 19.9.2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.597, DATË 10.9.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2014, NDËRMJET MINISTRISË SË KULTURËS DHE DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERTITARE, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHTESË PUNIMESH NË ZBATIM TË PROJEKTEVE "PËR RIKONSTRUKSIONIN E PALLATIT TË KONGRESEVE" DHE "PËR REALIZIMIN QENDRËS MEDIATIKE NË PALLATIN E KONGRESEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr.185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave
VENDOSI:

Në vendimin nr.597, datë 10.9.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Për rishpërndarje fondesh, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Kulturës, për mbulimin e shpenzimeve për shtesë punimesh në zbatim të projekteve "Për rikonstruksionin e Pallatit të Kongreseve" dhe "Për realizimin e Qendrës Mediatike në Pallatin e Kongreseve".

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2014 të bëhet rishpërndarja e fondeve, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Kulturës t'i shtohet fondi prej 2 800 000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekësh, për shpenzime kapitale, në programin "Trashëgimia kulturore dhe muzetë", për mbulimin e shpenzimeve të kontratës shtesë të punimeve në zbatim të projektit "Për rikonstruksionin e Pallatit të Kongreseve".

b) Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare t'i pakësohet fondi prej 2 800 000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekësh, në shpenzimet kapitale.

3. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

"1/1. Ministrisë së Kulturës, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, t'i shtohet fondi prej 21 507 334 (njëzet e një milionë e pesëqind e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekësh, ndarë, si më poshtë vijon:

a) 3 531 173 (tre milionë e pesëqind e tridhjetë e një mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë, për shpenzime kapitale, për mbulimin e shpenzimeve të kontratës shtesë të punimeve në zbatim të projektit "Për rikonstruksionin e Pallatit të Kongreseve".

b) 8 900 000 (tetë milionë e nëntëqind mijë) lekë, për shpenzime korrente, për mbulimin e shpenzimeve për projektin "Për realizimin e Qendrës Mediatike në Pallatin e Kongreseve".

c) 9 076 161 (nëntë milionë e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e një) lekësh, për shpenzime korrente, për mbulimin e shpenzimeve "Për realizimin e pjesëve të dekorit të Altarit".

Fondi prej 21 507 334 (njëzet e një milionë e pesëqind e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekësh, të përballohet nga fondi i kontingjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2014".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama